



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/9569/2021

Duke u bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës me nr. 03/L-040, neni 13 mbi aktet e Kryetarit të Komunës, Ligjin për Vula në Institucionet e Republikës së Kosovës nr.03/L034, neni 8 si nen i përgjithshëm, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 9 Vulat e Komunës, Kryetari i Komunës së Hanit të Elezit, nxjerrë:

V E N D I M

Për ndryshimin e vulës katrore dhe eliminimin e vulave hyrëse dhe dalëse

1. Me këtë vendim bëhet ndryshimi i vulës katrore e komunës Hani i Elezit, e cila do të ketë përmbajtjen e vulës katrore si në nenin 8 të Ligjit për Vula, ndërsa në të nuk do të shënohet as hyrëse as dalese, por do të jetë katrore dhe me përmbajtje sipas nenit 8, paragrafi 8.3 i ligjit për Vula.
2. Pas punimit të vulës katrore nga vulëpunuesi, sipas nenit 8 të Ligjit për Vula të Republikës së Kosovës, bëhet edhe eliminimi i vulave të deritanishme që kanë qenë hyrëse dhe dalëse.
3. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.
4. Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria për Administratë të Përgjithshme, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Vulëpunuesi dhe Arkivi i Komunës së Hanit të Elezit.

Data : 05.01.2021
Hani i Elezit



Kryetari i Komunës
Rufki Suma